

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN
PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK



PUNIM MASTER

**Zyra e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) si institucion i ri
dhe krahasimi me Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF)**

Mentori:

Prof. Dr. Flamur Mrasori

Studenti:

Adriatik Halitaj

Prishtinë, 2023

ABSTRAKT

OLAF dhe EPPO mund të duken në pamje të parë si shumë të ngjashëm: të dy janë organe të BE-së të specializuara në mbrojtjen e interesave financiare të tyre. Një vështrim më i afërt zbulon disa dallime në natyrën e tyre (organi i komunitetit kundër organit të drejtësisë penale), në kompetencat e tyre përkatëse hetuese (hetimet administrative të parregullsisive administrative kundrejt hetimeve penale të veprave penale) dhe në aftësinë e tyre për të kryer procedura penale (inexistente për OLAF).

Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Zyra e Prokurorit Publik Evropian (EPPO) janë dy organet hetimore në nivel të BE-së që qëllim të përbashkët kanë të zbulojnë, hetojnë dhe mbrojnë në mënyrë efektive interesat financiare të BE-së duke bashkëpunuar me njëra tjetrën.

Dallimet e tyre, që kufizojnë rreptësisht rrezikun e mbivendosi midis aktiviteteve të tyre, do të ndikojnë në marrëdhënien e tyre. Në të vërtetë, si rezultat, të dy organet janë shumë komplementare, duke reflektuar komplementaritetin midis pistave të drejtësisë administrative dhe penale në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Marrëveshja mes tyre synon të krijojë një partneritet të ngushtë midis dy zyrave në ushtrimin e mandateve të tyre përkatëse hetimore dhe prokuroriale, veçanërisht nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe mbështetjes reciproke. Marrëveshja e punës thjeshtëson më tej bashkëpunimin dhe krijon një kuadër operacional (në bazë të legjislacionit të përcaktuar)

Marrëveshja e punës parashikon që të dyja zyrat mund të vlerësojnë tekstin pas një periudhe të përcaktuar kohore dhe të adresojnë çdo mangësi të mundshme.

Bashkëekzistenca e OLAF-it dhe EPPO-së do të lejojë të përcaktohet rast pas rasti se cilat procedura administrative apo penale janë më të përshtatshmet për të ndjekur një sjellje specifike. Në këtë drejtim, bashkëpunimi i tyre do të jetë thelbësorë për nxitjen e sinergjive të reja dhe përmirësimin e efikasitetit.

Pra ky punim ka për qëllim të trajtoj të dy zyrat duke filluar nga historiku i themelimit të tyre duke përfshirë dallimet që kanë me njëra tjetrën e deri tek rëndësia që të dy zyrat kanë në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, duke përfshirë mashtrimin në lidhje me fondet e BE-së. Më parë vetëm autoritetet shtetërore mund të hetonin dhe ndjeknin penalisht këto raste pasi që nuk mund të vepronin përtej kufijëve të tyre, mirpo me themelimin e EPPO (Zyra e Prokurorit Publik Evropian) fushëveprimi i saj është më i madh në ndjekjen e këtyre rasteve.

EPPO përbëhet nga zyra qendrore e cila ka një Kryeprokuror evropian i mbështetur nga 22 Prokurorë evropian, si dhe staf mbështetës dhe hetues.

Prandaj, duke i parë këto qëllime edhe kapitulli i parë përfshinë metodologjinë e hulumtimit, qëllimet e hulumtimit si dhe strukturën e punimit

Kapitulli i dytë është i orientuar në rishikimin e literaturës ku përfshihet historiku i themelimit të Zyrës së Prokurorit Publik Evropian si dhe Zyrës Evropiane kundër Mashtrimit, funksionet e të dy zyrave, kompetencat që ato kanë si dhe struktura organizative e tyre.

Pra EPPO ka një strukturë që përbëhet nga niveli qendror dhe kombëtar, niveli qendror është i vendosur në Luksemburg dhe përbëhet nga një Kryeprokuror evropian si dhe një kolegji Prokurorësh. Kryeprokurori menaxhon EPPO-në, organizon punën e saj si dhe përfaqëson zyrën në kontaktet me institucionet e BE-së, shtetet anëtare si dhe vendet jo anëtare të BE-së. Ndërsa niveli kombëtar përbëhet nga prokurorët e deleguar evropianë dhe dhomat e përhershme. Ku prokurorët e deleguar në vendet anëtare të BE-së janë përgjegjës për kryerjen e hetimeve si dhe ndjekjen penale të kryerësve të këtyre veprave të kundërligjshme, ndërkaq dhomat e përhershme monitorojnë dhe drejtojnë hetimet si dhe marrin vendime operacionale.

Ndërsa Zyra Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF) është themeluar në prill të vitit 1999 e cila kishte për qëllim për të hetuar mashtrimet e mundshme të financimit të buxhetit të BE-së, gjithashtu në struktura organizative të saj ka dhe tri drejtori të cilat mbështesin hetimet si dhe veprimet e tjera të nevojshme. Më tej kemi edhe rastet e studimit të hetuara nga OLAF ku kemi marrë Hungarinë si dhe Rumaninë për arsye se në këto vende ka pas shkallë të lartë të korrupsionit si dhe mungesë të ekspertëve për trajtimin e këtyre rasteve ku kemi dëmtim në shuma të mëdha monetare të buxhetit të BE-së .

Ndërsa kapitulli i tretë i referohet bashkëpunimit ndërmjet OLAF dhe EPPO- së, dallimeve kryesore që këto dy zyra kanë me njëra tjetrën, bashkpunimi praktik mes tyre si dhe ndihma që këto dy zyra i japin njëra tjetrës.

Gjithashtu që ky punim të jetë sa më signifikant dhe që hipotezat të gjejnë mbështetje atëherë i kemi paraqitur edhe pyetjet kërkimore:

1. Cilat janë mekanizmat kryesor të funksionimit të zyrës së EPPO dhe OLAF në kuadër të BE?
2. Çfarë janë perceptimet e zyrtarëve të tjerë të BE-së mbi funksionimin dhe organizimin e EPPO dhe OLAF?
3. Cilat janë dallimet kryesore në kuadër të natyrës së funksionimit dhe misionit ndërmjet EPPO dhe OLAF?

Ndërsa Hipotezat e punimit janë: **H1**: Ekzistojnë dallime signifikante në mekanizmat e funksionimit të zyrëve të EPPO dhe OLAF

H2: EPPO dallon nga OLAF për sa i përket natyrës së funksionimit dhe misionit që përfaqëson.

Në fund është e rëndësishme të vihet në pah rëndësia e këtij hulumtimi sa i përket paraqitjes së zyrave përkatëse dhe rolit të rëndësishmëm që ato kanë në Bashkimin Evropian.

Fjalë kyçe: OLAF, EPPO, BE